



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Roskovec, më 01.07.2020

Nr. 8140 Prot.

VENDIM
NR 52 .DATË 29 .06.2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.27 DATË 27.04.2020
“PËR SHITJEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME NË PRONËSI TË BASHKISË
ROSKOVEC, PËR FAMILJET QË KANË MBETUR TË PASTREHA PËR SHKAK TË
INVESTIMIT PËR INTERES PUBLIK DHE PËRJASHTIMIT NGA PROCESI I
LEGALIZIMIT”**

Në mbështetje të Kodi Civil nenet : 83, 705, 750 , 751, 901, 902, 903, 904, 905, 908, 912; Kodi i Procedurave Administrative neni 113 ; të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c', neni 24 pika 2, neni 54 gërma 'e'; Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin Social “ neni 6 , pika 1 dhe Kreu VII i tij; Aktmarrëveshjes nr.3027 prot. datë 26.06.2020 “Për ndërtim memoriali Roskovec ; si dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr.76 datë 18.10.2018 "Për miratimin e investimit për ndërtimin e një godine 3-katëshe për strehim social" ; nr.84 datë 18.10.2018 "Për pagesën e qerasë për familjet në nevojë", konfirmuar; nr.27 datë 24.04.2020 “Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1.Miratimin për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.27 datë 27.04.2020 “Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec , për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit”.

2.Pika 1 e VKB-së nr.27 datë 27.04.2020 ndryshohet si më poshtë:

2.1 Miratimin për shitjen e pronës publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas certifikatës së pronësisë bashkëlidhur , familjes me kryefamiljar **z.Fatmir Kasëmaj**, që ka rezultuar e pastrehë si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec", banesa e të cilës prishet për shkak të interesit publik , është përjashtuar nga procesi i legalizimit dhe që nuk shpronësohet, konkretisht me të dhënat:

- Apartament nr.1
- Sipërfaqja : 84 (tetëdhjetë e katër) m2
- Hyrja 1+1
- Kati : I-re



- Pozicionimi : Apartament në anën jugore të godinës 3-katëshe
Në anën lindore :Shkolla 9-vjecare “Alush Grepcka”
Në anën perëndimore :rrugë
Në anën veriore : banesa të tjera

Programi social që do të zbatohet , është “Banesë me Kosto të Ulët (BKU)” sipas Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”.

3.Pika 2 e VKB-së nr.27 datë 27.04.2020 ndryshohet si më poshtë:

3.1 Miratimin për shitjen e pronës publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas certifikatës së pronësisë bashkëlidhur , familjes me kryefamiljar **znj.Naxhie Driza** , që ka rezultuar e pastrehë si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik “*Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec*”, banesa e të cilës prishet për shkak të interesit publik , është përjashtuar nga procesi i legalizimit dhe që nuk shpronësohet. Porgrami social që do të zbatohet , është “Banesë me Kosto të Ulët (BKU)” sipas Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”.

3.2 Në rast refuzimi të blerjes së pronës, **miratohet si alternativë strehimi të përkohshëm, huapërdorjen e sendit të paluajtshëm , pronës publike** në pronësi të bashkisë Roskovec sipas certifikatës së pronësisë bashkëlidhur , familjes me kryefamiljar **znj.Naxhie Driza**.

3.3 Afati i huapërdorjes do të jetë 1 (vit) , me të drejtë përsëritjeje.

4.**Shfuqizimin** pjesërisht të pikës 2 të VKB-së nr.27 datë 27.04.2020 , për **shitjen e pronës publike/apartament** për familjen me kryefamiljar **z.Shkëlqim Begaj**.

5. Pika 3 e VKB-së ndryshohet si më poshtë:

Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së pronës së paluajtshme të parashikuar në këtë vendim, nëpërmjet shitjes, do të kryhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.

6.Ngarkohet Komisioni për kryerjen e procedurave të zhvendosjes dhe grupi i punës për procedurat e shitjes për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas neni 55 pika 6 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

